

**FIGURA E ELFETE HUMOLLIT NË HISTORINË E  
DEMONSTRATAVE TË VITEVE ‘90**

**TEMA PËR TITULLIN**

**MASTER I HISTORISË**

**NGA**

**EGZONITË BERISHA**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI FILOZOFIK**

**PRISHTINË**

**KORRIK, 2026**

## **REZYME**

### **“FIGURA E ELFETE HUMOLLIT NË HISTORINË E DEMONSTRATAVE TË VITEVE ‘90”**

Mentori: Prof. Ass. Dr. Mentor Hasani

Kandidatja: Egzonitë Berisha

Ky punim trajton figurën e Elfete Humollit dhe kontributin e saj në historinë e demonstratave të viteve '90 në Kosovë, duke analizuar rolin e saj në rezistencën qytetare dhe angazhimin për mbrojtjen e të drejtave kombëtare e politike të shqiptarëve. Në fokus të hulumtimit janë rrethanat historike dhe politike që çuan në demonstratat e kësaj periudhe, zhvillimi i tyre, si dhe pjesëmarrja dhe kontributi i Elfete Humollit në demonstratat e viteve '90, duke evidentuar angazhimin e saj në rezistencën qytetare kundër rrethanave politike dhe shoqërore të kësaj periudhe.

Punimi synon të analizojë zhvillimet politike në Kosovë duke filluar nga Kushtetuta e vitit 1974 dhe rëndësia e saj në përcaktimin e pozitës kushtetuese të Kosovës në kuadër të RSFJ-së, demonstratat e viteve 1981, zhvillimet politike fundviteve '80, grevën e minatorëve të Trepçës, suprimimin e autonomisë së Kosovës dhe demonstratat e viteve '90. Në këtë kontekst, një rëndësi e veçantë i kushtohet figurës së Elfete Humollit si pjesëmarrëse në këto demonstrata, duke analizuar kontributin dhe angazhimin e saj në rezistencën qytetare dhe në mbrojtjen e të drejtave kombëtare të shqiptarëve në Kosovë.

#### **Qëllimi i hulumtimit**

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë figurën dhe veprimtarinë e Elfete Humollit në kuadër të demonstratave të viteve '90, duke vlerësuar kontributin e saj në rezistencën qytetare. Studimi synon të shqyrtojë faktorët historikë e politikë që ndikuan në organizimin e demonstratave, të analizojë rolin e Elfete Humollit në këto zhvillime dhe të evidentojë rëndësinë e saj në historiografinë bashkëkohore shqiptare. Përmes analizës së burimeve arkivore, shtypit të kohës, literaturës shkencore dhe intervistave punimi synon të japë një pasqyrë sa më të plotë të figurës së Elfete Humollit dhe të pjesëmarrjes së saj në demonstratat e viteve '90 në kuadër të zhvillimeve politike dhe shoqërore të Kosovës.

### **Objektivat specifike të hulumtimit janë:**

- Të analizohen rrethanat historike, politike dhe shoqërore që çuan në demonstratat e viteve '90 në Kosovë;
- Të trajtohet jeta dhe veprimtaria e Elfete Humollit;
- Të analizohet pjesëmarrja dhe angazhimi i Elfete Humollit në demonstratat e viteve '90;
- Të vlerësohet ndikimi i demonstratave në zhvillimet politike dhe shoqërore në Kosovë;
- Të evidentohet rëndësia e figurës së Elfete Humollit në historinë bashkëkohore të Kosovës.

### **Pyetjet hulumtuese**

1. Cili ka qenë roli i Elfete Humollit në pjesëmarrjen dhe angazhimin në demonstratat e viteve '90?
2. Cilat ishin zhvillimet kryesore politike dhe shoqërore në Kosovë gjatë fundviteve '80 që ndikuan në përshkallëzimin e pakënaqësisë së shqiptarëve?
3. Si është ndërtuar dhe ruajtur figura e Elfete Humollit në kujtesën kolektive dhe në historiografinë e Kosovës?

### **Metodologjia e punimit**

Ky hulumtim mbështetet në metodën historiko-analitike, të kombinuar me metodën krahasuese dhe interpretimin kritik të burimeve historike. Në realizimin e studimit janë shfrytëzuar burimet primare, si dokumentet arkivore, shtypi i kohës, intervista me dëshmitarë të ngjarjes si dhe familjarë të cilat ofrojnë dëshmi të drejtpërdrejta mbi zhvillimet historike të periudhës. Njëkohësisht janë përdorur edhe burime sekondare, të përbëra nga literatura shkencore vendore dhe ndërkombëtare, që trajton historinë politike të Kosovës dhe demonstratat e viteve '90 dhe figurën e Elfete Humollit. Analiza është ndërtuar mbi shqyrtimin kritik të burimeve, me qëllim ndriçimin e figurës së Elfete Humollit dhe të demonstratave në historinë moderne të Kosovës.

### **Struktura e punimit**

Ky punim është i strukturuar në katër kapituj. Në kapitullin I, është trajtuar konteksti politik dhe institucional i Kosovës gjatë periudhës 1974-1990, duke filluar nga statusi juridik i

Kosovës i përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974, funksionimi i institucioneve autonome dhe zhvillimet politike që çuan në rritjen e tensioneve në fund të viteve '80. Gjithashtu është analizuar rëndësia e demonstratave të vitit 1981, pasojat e tyre politike dhe shoqërore, si dhe ngritja e nacionalizmit serb dhe ardhja në pushtet e Slobodan Miloševićit, faktorë që ndikuan drejtpërdrejt në zhvillimet e mëvonshme në Kosovë.

Kapitulli II trajton demonstratat e viteve 1989-1990 dhe dinamikën e rezistencës shqiptare në Kosovë. Në këtë pjesë analizohen ndryshimet kushtetuese, procesi i heqjes së autonomisë së Kosovës në vitin 1989, reagimet institucionale dhe shoqërore ndaj këtyre zhvillimeve, si dhe mënyra se si popullsia shqiptare u mobilizua përmes formave të ndryshme të rezistencës qytetare.

Në kapitullin e III, analizohet figura e Elfete Humollit në kuadër të demonstratave të vitit 1990, duke u përqendruar në pjesëmarrjen dhe rolin e saj në këto ngjarje historike. Në këtë kapitull trajtohet zhvillimi i demonstratave, dëshmitë e pjesëmarrësve, burimet historike dhe interpretimet institucionale rreth ngjarjes së 1 shkurtit 1990.

Kapitulli IV trajton figurën e Elfete Humollit në kujtesën kolektive dhe historiografike. Në këtë pjesë shqyrtohen kujtimet familjare, formimi i saj, bindjet dhe angazhimi qytetar, rrethanat e vdekjes së saj, si dhe mënyra se si kjo figurë është ruajtur dhe interpretuar në kujtesën shoqërore të Kosovës. Përmes këtij kapitulli synohet të vlerësohet rëndësia e Elfete Humollit si simbol i pjesëmarrjes qytetare dhe i rolit të grave në proceset historike të viteve '90.

## **Rezultatet e hulumtimit**

Rezultatet e hulumtimit mundësuan vërtetimin e hipotezës kryesore, sipas së cilës Elfete Humolli, përmes pjesëmarrjes dhe angazhimit të saj në demonstratat e viteve '90, dha një kontribut të rëndësishëm në rezistencën qytetare, duke u shndërruar në një figurë me rëndësi në lëvizjen kombëtare të Kosovës. Po ashtu, u vërtetua edhe hipoteza e dytë, sipas së cilës ngjarjet e fundviteve '80 dhe demonstratat e viteve '90 përbënin një fazë vendimtare të rezistencës politike të shqiptarëve të Kosovës ndaj politikave represive të Serbisë. Njëkohësisht, analiza e burimeve arkivore, literaturës shkencore dhe dëshmimeve gojore dëshmoi vlefshmërinë e hipotezës së tretë, sipas së cilës studimi i figurës së Elfete Humollit kontribuon në pasurimin e historiografisë shqiptare, duke nxjerrë në pah rolin e grave në proceset politike dhe kombëtare të Kosovës gjatë viteve '90.

## **Përfundimet**

Hulumtimi arrin në përfundimin se figura e Elfete Humollit paraqet një pjesë të rëndësishme të historisë së demonstratave të viteve '90 në Kosovë, duke reflektuar rolin e gruas shqiptare në proceset politike dhe shoqërore të kësaj periudhe. Analiza historike dëshmon se demonstratat u zhvilluan në një klimë të rënduar politike, të karakterizuar nga suprimimi i autonomisë së Kosovës, represioni institucional dhe kufizimi i të drejtave politike e shoqërore të shqiptarëve. Në këtë kuadër, veprimtaria e Elfete Humollit dëshmon përfshirjen aktive të individëve në përballjen me këto zhvillime dhe në ruajtjen e kërkesave për të drejta dhe barazi. Studimi evidenton se roli i saj nuk duhet parë vetëm si një angazhim individual, por edhe si pjesë e një procesi më të gjerë historik të rezistencës dhe mobilizimit shoqëror në Kosovë.

**Fjalët kyçe:** *Elfete Humolli, demonstratat e viteve '90, rezistenca politike, aktivizmi qytetar.*